

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje Karburanti”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

09100000-0 - Karburante.

VLERA E FONDIT LIMIT:

37,805,939 (tridhjetë e shtatë milion e tetëqind e pesë mijë e nëntëqind e tridhjetë e nëntë) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **“Operatori i Sistemit te Transmetimit” (OST) sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, te paktën 35,000,000 (tridhjetë e pesë milion) Lekë.

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e siperpermendura dhe kopje të certifikuara të balanceve ku të paktën në dy balance, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasine dhe cilësinë e mallrave objekt procedure prokurimi, kërkohej që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të realizuar ato në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për tre vitet e fundit financiare të jete në masën 35,000,000 (tridhjetë e pesë milion) Lekë.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kontrata të ngjashme në një vlerë të pakten prej 15,000,000 (pesëmbëdhjetë milion) Lekë pa TVSH.

Lidhur me këtë pikë:

Kur OE ka realizuar kontrata me një ent publik, kërkohej vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasinë dhe cilësinë e mallrave objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë me kontrata të ngjashme, të jetë 39 % të vlerës të fondit. Në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

2.3.2 *Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Lejën e Tregëtimit të Karburanteve, në përputhje me Ligjin Nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”.*

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e pikes 5/a të nenit 40, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në lidhje ushtrimin e aktivitetit objekt procedure prokurimi.

2.3.3 *Operatori ekonomik ofertues duhet të garantojë furnizimin me karburant sipas standarteve shtetërore në fuqi S SH EN 590:2022 per Gazoil (10 ppm ULSD) dhe S SH EN 228:2012+A1:2017 per Benzine (Premium Unl 10 ppm), me tollona (bileta) të vlefshme në pika shitje karburanti (me shërbim 24 orë, çdo ditë të javës), të vendosura në qytetet e mëposhtme, në të cilat ushtrojnë aktivitetin Njësitë Operative të OST sh.a.: Tiranë, Durrës, Shkodër, Lezhë, Burrel, Elbasan, Lushnjë, Fier, Vlorë, Korçë, Gjirokaster, Sarandë.*

Në lidhje me plotësimin e këtij kriteri kualifikues, ofertuesi duhet të paraqesë një deklaratë, sipas të cilës merr përsipër dhe garanton gjithçka sa më sipër dhe ku të cilësohen emërtimet e pikave, vendndodhjet dhe adresat e sakta të tyre, numrat e telefonit dhe personi i kontaktit. Informacioni për pikat e furnizimit në qarqet e mesiperme duhet të jetë njëkohësisht i verifikueshëm nëpërmjet ekstraktit të QKB-së. Në deklaratë të cilësohet gjithashtu që (tollonat) bilete do të përmbajnë emrin tregëtar të shoqërisë/ve kontraktuese, si dhe do të jenë pa afat skadence, dhe të përmbajnë të gjithë elementet e sigurisë.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e pikes 4/c të nenit 40, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në lidhje ushtrimin e aktivitetit objekt procedure prokurimi.

Gjithashtu, në lidhje me kërkesën për pika karburanti në qytetet e mesiperme dhe në shërbim 24 orë, është e lidhur ngushtësisht me veprimtarinë e OST sh.a. e cila ushtrohet në qytete të mesiperme nëpërmjet njësieve operative të OST sh.a.

Persa i perket kerkesës për furnizim me karburant 24 ore ne cdo dite te javes eshte i rendesishem pasi veprimtaria e OST sh.a. eshte e tille qe ushtrohet 24 ore ne dite.

2.3.4 *Operatori ekonomik duhet te kete paguar taksat vendore per gjithë vitin 2022.*

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues nga Drejtorite Rajonale te Tatimeve.

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur në përputhje me parashikimet e pikes 2, te nenit 76, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik” dhe i jep sigurine Autoritetit Kontraktor qe OE ofertues ploteson detyrimet ligjore per te marre pjese ne prokurimet publike.

2.3.5 *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë analizat e furnizimit të fundit para zhdoganimit ose raport-analiza të lëshuara nga autoritetet përkatëse (jo më parë se 3(tre) muaj nga data e hapjes së ofertave), të bëra nga laborator i ISHTI-it për Artikujt Gazoil (10 ppm ULSD) dhe Benzine (Premium Unl 10 ppm), në përputhje me standartet shqiptare, shoqëruar me certifikatën e origjinës dhe cilësisë së mallit.*

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e pikes 4/c, te nenit 40, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ne lidhje ushtrimin e aktivitetit objekt procedure prokurimi. Ky kriter i jep sigurine Autoritetit Kontraktor qe malli objekt procedure prokurimi ka standartet e nevojshme.

2.3.6 *Operatori ekonomik ofertues qe do te realizoje kete kontrate, duhet te jete i pajisur dhe te paraqese certifikatat e vlefshme te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te akredituara nga DPA, ose organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, qe kane lidhje me objektin e kontrates, si me poshte:*

- *ISO 14001: për sistemin e menaxhimit të cilësisë së mjedisit.*
- *ISO 9001: për sistemin e menaxhimit të cilësisë.*
- *ISO 45001: për sistemin e menaxhimit te sigurise ne pune.*

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve të bashkimit duhet t'i disponojë këto certifikata.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ne baze te Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2502 Prot., date 09.04.2021, si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për

akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku percaktohet se këto Certifikata duhet të jenë të lëshuara nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të kryer shërbimin objekt kontrate. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Certifikata per menaxhimin e cilesise ISO 9001: eshte referimi i njohur ne nivel nderkombetar, per certifikimin e sistemit te menaxhimit te cilesise te kompanive te te gjithë sektoreve dhe te gjithë permasave. Ky kriter kerkohet nga AK me qëllim për të vërtetuar cilësinë e shërbimit dhe të garantojë realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standardeve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

Standardi i menaxhimit te cilesise se mjedisit ISO 14001: eshte kerkuar nga AK pasi garanton se OE ofertues eshte i kujdesshem ndaj mjedisit, duke tregtuar edhe lende te cilat kane ndikim te theksuar ne mjedis, kjo edhe sipas parashikimeve te pikes 7/c, te nenit 40, te VKM Nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar.

Certifikata për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ISO 45001: eshte vendosur si kriter kualifikues per operatorët ekonomik ofertues sepse ka te beje me sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, e cila eshte me nje rendesi te vecante per kryerjen e ketij shërbimi. OE ofertues qe do te realizoje kontraten objekt procedure prokurimi duhet te kryeje shërbimin edhe prane AK, ne rastin kur do furnizojë me karburant automjete te renda te cilat nuk mund te paraqiten prane pikave te OE.

AK duhet te marre çdo mase te nevojshme per parandalimin dhe mos cenimin e veprimtarise se saj.

Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe nenin 79, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese Leje mjedisore te tipit B, te leshuar nga QKL, Akt-Teknik te leshuar nga PMNZH, dhe Police Sigurimi lëshuar nga shoqerite e sigurimeve qe operojne ne Shqiperi.

Argumentimi: Kjo kerkese eshte e rendesishme pasi garantojn Autoritetin Kontraktor qe operatori ekonomik ofertues siguron perputhshmerine e aktivitetit te tij me kerkesat mjedisore duke garantuar reduktimin, minimizimin apo shmangin e ndikimeve ne mjedis te instalimeve ndotese, duke respektuar standartet kombetare. Akti teknik leshuar nga PMNZH eshte i rendesishem pasi tregon qe operatori ekonomik ofertues ka marre masa dhe vepron ne perputhje me legjislacion Shqiptar.

- 2.3.8 Bazuar ne VKM Nr. 561 date 29.07.2016 “Per standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve te karburantit ne njesite e qeverisjes se pergjithshem” i ndryshuar, Operoret ekonomik pjesemarres duhet te ofrojne nje faqe menaxhimi te karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit per mjetet efektive te transportit te kryhet nepemjet kartes elektronike.
- 2.3.9 Faqja e menaxhimit te karburanteve (webpage) duhet te ofroje sherbimin e ngarkimit te sasise se karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qellim qe rimbushja e kartave elektronike te personalizuar me targon e mjetit si dhe administrimi i sasise se karburanteve te kryhet nga Autoriteti Kontraktor.
- 2.3.10 Faqja e menaxhimit te karburanteve duhet te ofroje edhe sherbimin per krijimin e struktures piramidale ne perputhje me strukturen piramidale te Autoritetit Kontraktor, sherbimin e furnizimit me karburant nepermjet kartave elektronike stikera (pulla), te cilat ngjiten ne xhamin e automjetit dhe ofrojne sherbimin e furnizimit me karburant vetem per ate automjet per te eliminuar levizjen e mundshme te targave nga mjetet e AK drejt mjeteve private, si dhe sherbimin e dergimit te fotografive me ane te e-mailit per cdo furnizim te kryer te mjetit prane stacionit te shitjes se karburanteve me pakice me qellim identifikimin e mjetit dhe perdoruesit te saj.
- 2.3.11 Disponimi / Ekzistenca e faqes se menaxhimit te karburanteve (webpage), se bashku me ofrimin sherbimeve te kerkuara me siper, do te demostrohen nga ana e operoreve ekonomik pjesemarres me shembuj per zbatimin ne praktike, ne prani te anetareve te KVO-se se Autoritetit Kontraktor perpara mbylljes se procesit te kualifikimit dhe shpalljes se fituesit.
- 2.3.12 Mos ofrimi i sherbimeve te kerkuara me siper ne menyre elektronike nepermjet Faqes se menaxhimit te karburanteve (webpage), qe ofron cdo Operator Ekonomik pjesemarres perben kusht per skualifikim.

Argumentimi: Kriteret e mesiperme jane vendosur ne perputhje dhe ne zbatim me VKM Nr. 561 date 29.07.2016 “Per standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve te karburantit ne njesite e qeverisjes se pergjithshem” i ndryshuar.

Kerkesa per disponimin e nje website te furnitorit eshte e rendesishme pasi furnizimi i karburantit me karte elektronike, transferimi i sasise se karburantit nga furnitor tek AK-ja behet ne menyre elektronike, vetem nepermjet website te furnitorit.

- 2.3.13 Autoriteti kontraktor per nevojat e veta, per shkak te llojeve te vecanta te disa mjeteve qe disponon, kerkon qe Operoret Ekonomik ofertues te ofrojne pervec sherbimit te furnizimit nepemjet kartes elektronike edhe sherbimin e furnizimit me karburant me ane te tollonave (biletave) sipas kerkeses se Autoritetit kontraktor.

Ne lidhje me plotesimin e ketij kriteri Operatoret Ekonomik ofertues duhet te deklaroje se ofron edhe sherbimin e furnizimit me karburant me ane te tollonave (biletave) sipas kerkeses se Autoritetit kontraktor.

2.3.14 Operatori Ekonomik ofertues, duhet te disponoje (ne pronesi ose me qira) te pakten 2(dy) autobote me kapacitet secili nga 1,000 Litra, per transportimin e karburantit prane pikave te ushtrimit te aktivitetit te OST sh.a., sipas kerkeses se saj.

Ne lidhje me plotesimin e ketij kriteri Operatoret Ekonomik ofertues duhet te disponoje per secilin autobus: certifikatën e pronësisë ose kontratën e qirasë, leje qarkullimi, siguracionin (e vlefshem), kolaudimin (e vlefshem) dhe foto.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Dy kriteret e mesiperme jane vendosur duke pasur parasysh faktin qe Autoritetit Kontraktor OST sh.a. nisur nga fusha e veprimtarise se vet posedon mjete te ndryshme te cilat domosdoshmerisht duhet te furnizohen me karburant. AK ka ne pronesi mjete te tonazhit te rende si vinca, makineri te vecanta etj, te cilat e kane te pamundur te furnizohen prane pompave te ofertuesit, per kete qellim kerkohet nga OE ofertues sherbimi i furnizimit me karburant me ane te tollonave por edhe autobotet per transportimin e karburantit atje ku OST sha, e ka te nevojshme, ne varesi te kerkesave te saj.

2.3.15 Ne funksion te plotesimit te Shtojces 8 “Formulari permbledhes i vetedeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet te jape te dhena te qarta si Emer, Mbiemer, Atesi, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje te skanuar te dokumentit te identifikimit (shqiptar ose te huaj), per Administratorin/Administratoret e shoqerise, Ortakun/Ortaket e shoqerise, perfaqesues te ndryshem te posacem te shoqerise, drejtues te ndryshem te shoqerise.

Argumentimi: Ky kriter vendoset referuar njoftimit të përbashkët Nr. 1155 prot, datë 01.02.2019, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 1001/1 prot, datë 01.02.2019, sipas parashikimeve të nenit 76/1, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Autoriteti Kontraktor OST sh.a. ka detyrimin e verifikimit të personave të cilët janë në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Per këtë arsye, verifikimi i ketyre personave kerkon te dhëna te sakta si emër, mbiemër, atesi, amësi, vendlindje, datëlindje e numrin personal të personi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike jane hartuar duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, per mallrat objekt procedure prokurimi, duke perlogaritur sasite e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve te nenit 36, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”.